



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREZANTIM I SHËRBIME NDAJ TË TRETËVE QË UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është institucion i arsimit të lartë, i cili ka në përbërjen e tij shtatë fakultete dhe një institut kërkimi dhe zhvillimi. Fusha e tij e ekspertizës përfshin të gjithë drejtimet inxhinierike, pa përjashtuar profilet e arkitekturës arkitekturës dhe inxhinierinë matematike dhe fizike. Traditat e këtij Universiteti fillojnë që në vitin 1951, me ngritjen e Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë, me një histori përpjekjesh, pune, arritjesh dhe suksesesh 69 vjeçare, në përmbushje të misionit të tij, në harmoni me kërkesat, zhvillimin e shoqërisë dhe të kulturës shqiptare, parimeve të konkurrencës konkurrencës dhe zhvillimit të tregut të punës.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, institucionet publike të arsimit të lartë gëzojnë autonomi financiare e cila garantohet nëpërmjet të drejtës për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore – shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike.

Bazuar në sa më sipër, Universiteti Politeknik i Tiranës ka ofruar dhe ofron ndaj të tretëve, shërbime të ndryshme në fushat e ekspertizës me natyrë teknike që ai mbulon si oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, analiza laboratorike, studime dhe kërkime shkencore të porositura nga personat fizik dhe juridik, vendas ose të huaj sipas marrëveshjeve të nënshkuara, trajnime, kurse apo kualifikime për të tretët, në të gjitha drejtimet inxhinierike, arkitekturës dhe urbanistikës, si dhe çdo lloj fushe që lidhet me industrinë nxjerrëse dhe prodhuese në tërësi.

Më konkretisht, fushat e ekspertizës së UPT përfshijnë:

- Shërbime në fushën e planifikimit të territorit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit, ku përfshihen hartime projektesh, raportesh, relacionesh teknike për të gjithë veprat e ndërtimit, përfshirë këtu fushën e restaurimit të monumenteve të kulturë aktekspertiza të thelluara, shërbime të vlerësimit në mjedis, shërbime topografike, studime gjeologjike – inxhinierike, studime të efikasitetit energjetic, përgatitje e dokumentacionit për tenderim të punimeve ndërtimore, duke përfshirë termat e referencës, apo detyrat e projektimit, si dhe çdo formë tjetër konsulence në fushën e projektimit, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi;
- Oponenca Teknike për Projektet e Veprave të Ndërtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Hartim i studimeve të fizibilitetit;
- Vlerësim i pasurive të paluajtshme;

- Ekspertizë gjyqësore për çështjet e lidhura me interpretimin e legjislacionit në fushën ndërtimore, zbatimin e punimeve ndërtimore, truallit dhe ndërtesës, si dhe vlerësimeve të pasurive të paluajtshme;
- Analiza inxhinierike, ku përfshihen analizat e ndryshme laboratorike dhe çdo formë tjetër analize, për të cilën institucioni ka marrë lejet, autorizimet, certifikimet e nevojshme apo çdo dokument tjetër ligjor, i cili e lejon atë t'a ofrojë konform përcaktimeve ligjore;
- Veprimtari studiuuese – projektuese në fushën e kërkim – zbulimit të mineraleve, ku përfshihen studimi, mbikqyrja, monitorimi, projektimi, konsulenca dhe vlerësimi për veprimtarinë kërkim – zbulimit të mineraleve;
- Shërbimet për të tretë, në fushën e sizmologjisë, dhe transferimin e njohurive të teknologjisë, në fushat e sizmologjisë, pasurive natyrore, të gjeoriskut, gjeoinxhinierisë dhe gjeoinformacionit.
- Shërbime për të tretë, si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjisë, në fushat e energjisë, ujit, mjedisit dhe klimës.
- Vlerësimi i potencialeve natyrore energjetike dhe, veçanërisht, i formave të energjisë së rinovueshme;
- Vlerësimi i aftësive transformuese të energjisë, impaktet mjedisore dhe hartimi i programeve kombëtare të shkarkimit të gazrave (Protokolli i Kioto-s).
- Studimi i ndryshimeve, klimatike dhe ujore, si dhe i impakteve të tyre ekonomiko-shoqërore;
- Parashikimi i dukurive e i proceseve atmosferike, të motit dhe klimës, si dhe i dukurive të jashtëzakonshme atmosferike;
- Studimi i gjendjes së mjedisit dhe i prirjeve të ndotjes së tij;
- Studimi i pasurive të ujërave për veprat hidroenergjetike, hidroteknike dhe portuale, me risqe të mëdha dhe impakt mjedisor;
- Hartim i studimeve dhe ekspertizave të vlerësimit strategjik mjedisor për projekte të ndryshme të zhvillimit rajonal.
- Hartim i studimeve dhe ekspertizave mbi projektet që lidhen me monitorimin e cilësisë së mjedisit urban, menaxhimin dhe rregullimin e baseneve ujore etj.
- Hartim i studimeve, projekteve dhe ekspertizave në fushën e naftës, gazit dhe energjisë gjeotermale.
- Shërbime konsulencash të kërkimit dhe zhvillimit, ku përfshihen edhe konsulencat në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, apo çdo formë tjetër konsulence, në përputhje me fushat studimore të UPT, të porositura nga personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj sipas marrëveshjeve të nënshkruara;
- Konsulencë në hartim legjislacioni, strategjish kombëtare/rajonale, normativash/standardesh në të gjitha drejtimitet e fushës ndërtimore, në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbejtjeve, në fushën e efikasitetit energjetic, energjive të rinovueshme, si dhe në fushën e restaurimit të monumenteve të kulturës;
- Shërbime konsulence në fushën e mbrojtjes nga rodoni;
- Ekspertizë në fushën e mbrojtjes dhe vlerësimit të dozave të rrezatimeve jo jonizuese për Low dhe High Frekuence.
- Ekspertizë në fushën e hartografisë, GIS dhe bazë të dhënash hapsinore;
- Etj.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 8402 dt.10/09/1998: “Për

kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 6, V.K.M. Nr. 1055 datë 22/12/2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit me objekte me vlerë mbi 100 milionë” dhe Urdhrit të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit Nr. 197, Date 09. 10. 2014, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Universiteti Politeknik i Tiranës ka lidhur dhe realizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi për kryejen e oponencave teknike të veprave të ndërtimit, të cilat deri në datë 20.06.2019 janë realizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit i UPT.

Duke nisur prej kësaj date dhe në vijim, oponencat teknike janë kryer në nivel institucioni, mbështetur në Urdhërin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 243, datë 12.06.2019 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr.197, datë 09.10.2014 të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Krahas shërbimeve të oponencave teknike të veprave të ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës kryen edhe shërbime në fushën e projektimit, realizimi i të cilave mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”.

Që prej hyrjes në fuqi të vendimit Nr. 188, datë 13.03.2019 më sipër cituar, UPT ka realizuar shumë shërbime në fushat e saj të ekspertizës, ku përfshihen edhe aktekspertizat e thelluara, të cilat realizohen mbështetur në VKM nr. 26 datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Universiteti Politeknik i Tiranës ka ofruar dhe ofron ndaj të tretëve, shërbime të ndryshme në fushat e ekspertizës me natyrë teknike që ai mbulon.